

FTESË PËR OFERTË

Numri i prokurimit: T-0003-03-2019

I. Autoriteti kontraktues: Banka për Biznes, Sh.a.

II. Lënda e kontratës: "Auditimi i pasqyrave financiare të Bankës për Biznes për vitin që mbaron me 31/12/2019"

III. Procedura e përdorur: E hapur

IV. Kushtet e ofertimit:

a) Afati kohor dhe vendi i dorëzimit të ofertave:

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertës në bankë është **27 mars 2019** deri në ora **14:00**.
- Adresa: Zyra e Prokurimit në Qendër, rruga e UÇK-së nr. 153, Prishtinë, Kosovë.

b) Oferta financiare dhe Oferta teknike duhet të ndahen nga njëra tjetra nëpër pliko (zarfa) të veçantë dhe të dyja së bashku me rastin e dorëzimit të ofertës duhet të vendosen në një zarf të përbashkët, në të cilin duhet të shënohet vetëm numri referues dhe përshkrimi i tenderit për të cilin e dorëzoni ofertën tuaj.

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm ligjor – çertifikatën e regjistrimit të biznesit dhe çertifikatën e numrit fiskal.
- Banka për Biznes është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e deklaruar nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarësi vlerën e TVSH-së. Çmimet të cilat nuk e kanë të ndarë vlerën e TVSH-së do të nënkuptohet se ajo është e përfshirë në çmim.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqes referenca/dëshmi nga institucionet me reputacion të lartë mbi shërbimet e ngjashme të ofruara gjatë 3 viteve të fundit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Oferta duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anuloj tenderin dhe/ose te ndryshoj karakteristikat e tenderit dhe t'i ftoj sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **21 mars 2019** në email adresën prokurimi@bpbbank.com dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-15:00.